



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 20.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës 18.06.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **MEB LLC** dhe të datës 19.06.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Extreme Clean sh.p.k**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Pastrimi i Objekteve të ISSH dhe SHFAKM”** me nr. prokurimi **206-24-3189-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohen**, si te pa bazuara kërkesat për rishqyrtim e OE **MEB LLC** e datës 18.06.2024 dhe **Extreme Clean sh.p.k** e datës 19.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Pastrimi i Objekteve të ISSH dhe SHFAKM”** me nr. prokurimi **206-24-3189-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 14.06.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 14.06.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operoret Ekonomik **MEB LLC** dhe **Extreme Clean sh.p.k** kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i Objekteve të ISSH dhe SHFAKM”** me nr. prokurimi **206-24-3189-2-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.06.2024, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE MEB LLC:

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe

Neni 60 Kriteret për dhënie të kontratës,

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Extreme Clean sh.p.k.:

Neni 1, 6, 7 dhe 59 i LPP-se

Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE MEB LLC:

1. **Të dispozitave të LPP-se në RK.**

➤ **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimin të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar që tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje të OE të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit si dhe Kriterin për dhënie të kontratës, si dhe bazuar në Vendimin e AK-se për shpërbllim të kontratës, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

➤ **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,**

Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-se në momentin kur ka marrë vendim që të propozoj për shpërbllim të kontratës tenderin e Grupit të OE, i cili sipas analizës së bere financiare nuk i plotëson kushtet për kualifikim dhe përzgjedhje për tu propozuar për kontratë, ndërkaq gabimisht ka vepruar në momentin kur Grupin e OE të cilat janë parashtrues të kësaj kërkesë i ka shpallur tenderues të pasuksesshëm sepse Grupi i OE "MEB LLC&KSF" MAJOR" ka ofruar dëshmi dokumentare mbi plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim dhe pjesëmarrje në tender, të cilat janë të përcaktuara në paragrafin; 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional të Dosjes së tenderit dhe të Njoftimit për kontratë si dhe në momentin kur nuk ka respektuar kriterin për dhënie të kontratës i cili është Çmimi më i ulte i tenderit të përgjegjshëm..
Ne vazhdim të kësaj kërkesë po citoj Kërkesat e AK-se të përcaktuara në paragrafin 9.1&9.2 të FDT-se ;

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
		Operatori ekonomik duhet të deklarohet se punëtorëve do t'ia paguaj pagën minimale neto 400 euro sipas Ligjit të Punës	Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do të paguaj minimum Pagan Neto 400 € për punëtorë

Ne vijim do te përpiqemi qe t' i argumentojmë pretendimet tona, dhe atë si në vijim;

Pretendimi nr 1,

Pretendojmë se Grupin e OE" Pro te ch clean" shpk & "Aroma Plus "sh.p.k , ka ofertuar me çmimin total te tenderit ne vlere prej 197,844.65 euro për periudhën prej 36 muajve , i cili sipas dëshmimeve te cilat do te ju ofrojmë nuk i mbulon te gjitha shpenzimet te cilat derivojne nga Ligjet e aplikueshme ne Kosove te cilat kane te bëjnë me realizimin e te drejtave te cilat i parasheh Ligji i Punës, obligimet te cilat derivojne nga Ligji mbi Procedurat tatimore dhe Ligjet tjera te aplikueshme ne Kosove.

Parashtruesi i kërkesës për Rishqyrtim ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare ne pajtim me kërkesën e AK-se, se do te i paguaj punëtorët 400 euro neto ne muaj duke nënshkruar dhe vulosur, **Deklaratën**, ku ka marre përgjegjësinë qe gjate periudhës se ekzekutimit te kontratës do te i paguaj 400 euro pagën mujore Neto për një punëtor te pastrimit ne Objekte të ISSH dhe SHFAKM, i cila ka qen kërkesë formale administrative për kualifikim dhe përzgjedhje te OE, si dhe ka ofruar dëshminë dokumentare ne pajtim me kërkesën e AK-se-Analize te detajuar financiare lidhur me vlerën e ofertuar e cila i mbulon te gjitha shpenzimet te cilat derviojne nga kërkesa e AK-se.

Autoriteti kontraktues në raste te tilla kur kërkohen analiza te tilla financiare duhet vetë Duke pasur parsysh faktin qe AK është bazuar ne nenin 31 te LPP-se qe ndërlihet me nenin 17 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik duke kërkuar dëshmi dokumentare ne FDT te dosjes se tenderit dhe ne Njoftimin për kontrate–Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do te paguaj minimum Pagan Neto 400 € për punëtorë si dhe ne paragrafin 2.11, dhe 2.12 ne Specifikim teknik te detyrueshëm Citoj piken 2.11. dhe 2.12 te Aneksit 1 te dosjes se tenderit e cila obligon OE i cili do ta ekzekutoj kontratën mesa vijon;

2.11 Ofruesi i shërbimeve duhet të ketë se paku 10 (punëtor)

2.11.1 8 punëtor do të Angazhohen në Institutin Special në Shtime dhe

2.11.2 2 punëtorë/e në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

2.12 Në ISSH 6 punëtor do të angazhohen për pastrimin e hapësirave të objekteve të ISSH-së dhe 2 (dy) punëtorë mirëmbajtës do të angazhohen për mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme të parkingut, depo njësisë se mbeturinave, kontejnerëve dhe pastrimin e oborrit nga mbeturinat nga reshjet, mbështetjen e stafit ne bartje dhe shkarkim te materialeve inventarit dhe te gjitha kërkesave tjera të cilat parashtrohen nga stafi i ISSH-së.

2.13 Ofruesi i shërbimeve do ti paguan të gjithë punëtorët pagë jo me pak se 400 € neto, konfirmo ligjit të punës në fuqi, Ofruesi i shërbimeve duhet te lidh kontrate me secili punëtorë dhe te kryen pagesën e të gjitha kontributeve në Administratën tatimore të parapara me ligje te Republikës se Kosovës. Rrogat e punëtorëve duhet të derdhen në llogarit e tyre jo me larg se me datën 5 në fillim të çdo muajit.

Në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 te LPP-se, Autoritetet kontraktuese mund të

vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se dhe që janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontratë kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit.

17.24 Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontratës të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike.

17.25 Autoriteti kontraktues mund të vendos, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh, si:

- a. detyrim për të rekrutuar persona të papunë, dhe në veçanti persona të cilët nuk janë në punë për një periudhë të gjatë, ose
- b. për të themeluar programe trajnimi për të papunët apo për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës; ose
- c. detyrim për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave apo diversitetit etnik ose racor.

Te drejtat e punëtorëve që janë përcaktuar me ligj të punës, këto te drejta të cilat janë specifikuar në specifikim teknik dhe kërkohen të inkorporohen në kontratë të punëtorëve.

Vlen të theksohet se te drejtat e punëtorëve që janë përcaktuar me ligj të punës, Kërkesa që ka qene në dosje të FTD-ja të pika 9.1&9.2 si dhe kereksa nga ankesi 1 i dosjes se tenderit i cili ka te beje me obligimin e OE qe te i paguaj punetoret higjienik me page mujore ne vlere prej 400 euro ne pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03 L-212 te punës, unë si perfaqesues ligjor i Grupit te OE, kam nxjerr disa te drejta te percaktaura ne Ligj te punes qe ju kane referuar kushtet e kontratës. Si nen kryesor është nenit 10, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 01.12.2010, punëdhënësi dhe punëmarrësi, si palë në marrëdhënien juridike të punës, hyjnë në Kontrate të punës me Afat të caktuar ose pa caktuar.

2.Punonjësi do të kryejë detyrat si Punëtor i pastrimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit janë përshkruar në përshkrimin e punës, i cili është pjesë e kësaj kontrate si Aneksin 1 të DT. Punonjësi do të kryej detyrat në objektet e ISSH dhe SHFAKM

3.Punonjësi krijon marrëdhënie pune me kohë të plotë. Orari i plotë është: 8 orë pune në ditë, 40 orë pune në javë.

4. Punëtorët do të marrin pagë bazë nga punëdhënësi së paku një herë në muaj në këmbim të punës së kryer, në nivelin ose me vlere 400 € neto, sipas dosjes së tenderit datës .

Neni 56 percakton ;

5.Punonjësi ka të drejtë në pagë shtesë si përqindje e pagës bazë:

- 1) 20% në orë për shërbimin e kujdesitarisë;
- 2) 30% në orë për turnin e natës;
- 3) 30% në orë për jashtë orarit;
- 4) 50% në orë për punë gjatë festave, dhe
- 5) 50% në orë për punë gjatë fundjavës.

6.Punonjësi ka të drejtën e kompensimit të pagës pa punuar, në rastet e mëposhtme:

1) gjatë pushimeve kur nuk ka punë;

2) gjatë shfrytëzimit të pushimit vjetor;

3) gjatë trajnimit dhe zhvillimit profesional të caktuar për, dhe

7. Punonjësi ka të drejtën e kompensimit të pagës bazë gjatë pushimit mjekësor:

1) 100% në rast të përdorimit të pushimit të rregullt mjekësor, mbi bazën deri në 20 ditë pune brenda një (1) viti, si dhe te drejtat tjera të mungeses nga puna me kompensim.

Pra siç po shihet disa nga këto kërkesa une si perfaqesues i Grupit te OE; MEB LLC&KSF"MAJOR" i kam nxjerr nga Ligji i Punës qe eshte thirr AK-ja dhe disa qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit janë kushte te kontratës, i takojnë Ligjit te punës dhe nuk duhet te jene **si kriteret te vlerësimit te dosjes se tenderit**. Gjithashtu as si pjese e analizës financiare pasi nuk mundesh ti parashihen ne analizë financiar te gjitha kushtet e kontratës se çdo OE i ka kushtet e veta dhe shpenzimet e veta, fitimin e vet e kështu qe vlerësimi i analizës financiare nuk duhet te jete si kriter i vlerësimit, gjithashtu ne baze te ligjit

Për vlerësim te kushteve te punës ne mes punëdhënësi dhe punëmarrësi si palë në marrëdhënien juridike të punës e qe hyjnë në Kontrate te punës i takon ligjit te punës, a është respektuar Ligji i punës, këtu vendosin exo ficio apo me kerkesë (ankese) te

punonjësve, Organet kompetente administrative te shtetit (Inspektorati i punës , Inspektoret e ATK-se) dhe ne fund Gjykata duke u bazuar ne kushtet e kontratës. Pretendoj se Analiza financiare qe është kërkuar si kriter është ne kundërshtim me neni 17.23 deri 17.26 pasi këto nene ju referohet kushteve te kontratës e ne këtë rast nuk është përgjegjësi e AK-se ti shqyrtoj.

Ne analize financiare nuk munden me u caktuar te gjitha kërkesat qe kërkohen me ligjin e prokurimit, me ligjin e punës, me ligjin e lehonisë me ligjin mbi sigurimet e punëtorëve, me ligjin e festave zyrtare e kështu me radhe te gjitha këto kriteret qe janë kërkuar ne baze te ligjit dhe rregullores janë kushte te kontratës ne mes punëdhënësit dhe punëmarrësit qe nuk duhet te jene kriteret te vlerësimit.

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara pretendojmë se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se.

➤ Neni 60 Kriteret për dhënie kontratës

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili është rekomanduar për shpërblyer te kontratës dhe ka ofruar çmimin i cili nuk i mbulon shpenzimet e përcaktuara ne aneksin 1 te dosjes se tenderit , ka bere shkelje te dispozitës se nenit 60 te LPP-se , duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qen i përcaktuar ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit te përgjegjshëm.
Citoj dispozitën e nenit 60 te LPP-se;

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 të LPP-se pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të këtij neni me rastin e marrjes së Vendimit për dhënie të kontratës për OE i cili për nga çmimi është më të lartë, pra AK nuk ka respektuar Kriterin për dhënie të kontratës.

Duke pasur parasysh këto fakte i propozoj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që të pas administrimit të provave dhe fakteve që të marrë këtë;

VENDIM

- **TE APROVOJ**, Kërkesën për rishqyrtim si të bazuar të parashtruar nga Grupi i OE; MEB LLC & KSF "MAJOR" SH.A,
 - **TE ANULOJ**, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se të datës 14.06.2024 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblim të kontratës Grupi i OE: "Pro te ch Clean" sh.p.k & "Aroma Plus" sh.p.k me vlerë totale të tenderit prej 197,844.65 i cili ka ofertuar me çmimin total të tenderit i cili nuk i mbulon shpenzimet që derivojnë nga Ligji i punës, Ligji mbi Procedurat e Administratës Tatimore të Kosovës, Ligjit mbi skemat pensioneve dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, në krahasim me parashtruesin e kërkesës i cili me çmimin e dhënë të tenderit do të mbulojë të gjitha shpenzimet e parapara me Ligj të punës.
- TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM**, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes të cilat janë të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit në pajtim me LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik të vitit 2023.

Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE Extreme Clean sh.p.k.:

Kërkesa për pagat e punëtorëve ka qenë (pjesë e shkëputur nga dosja e tenderit):

Operatori ekonomik duhet të deklarohet se punëtorëve do t'u paguaj pagën minimale neto 400 euro sipas Ligjit të Punës

Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do të paguaj minimum Pagan Neto 400 € për punëtorë

Si e tillë kërkesa jep automatikisht një vlerë minimale të pagave duke u bazuar edhe në kërkesën e numrit të punëtorëve të cilët të ANEKS 1 kanë qenë të kërkuar minimum 10 punëtor, që dmth

2.11 Ofruesi i shërbimeve duhet të ketë së paku 10 (punëtor)

2.11.1 8 punëtor do të angazhohen në Institutin Special në Shtime dhe

2.11.2 2 punëtorë/e në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

2.12 Në ISSH 6 punëtor do të angazhohen për pastrimin e hapësirave të objekteve të ISSH-së dhe 2 (dy) punëtorë mirëmbajtës do të angazhohen për mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme të parkingut, deponis së mbeturinave, kontejnerëve dhe pastrimin e oborrit nga mbeturinat nga reshjet, mbështetjen e stafit në bartje dhe shkarkim të materialeve inventarit dhe të gjitha kërkesave tjera të cilat parashtrohen nga stafi i ISSH-së.

2.13 Ofruesi i shërbimeve do ti paguan të gjithë punëtorët pagë jo me pak se 400 € neto, konfirmo ligjit të punës në fuqi, Ofruesi i shërbimeve duhet të lidh kontrate me secili punëtor dhe të kryen pagesën e të gjitha kontributeve në Administratën tatimore të parapara me ligje të Republikës së Kosovës. Rrogat e punëtorëve duhet të derdhen në llogaritë e tyre jo me larg se me datën 5 në fillim të çdo muajit.

Pas kalkulimit të pagave që janë :

Një pagë puntori netto 400 euro e që brutto me të gjitha shpenzimet I bie të jetë 464.69 euro ku janë të përfshira kontributet nga punëmarrësi dhe punëdhënësi e poashtu edhe tatim në burim i pagës I bie që për 10 punëtorë të jenë gjithsej 10×464.69 euro = 4646.9 pa tvsh kur shtojmë edhe tvsh taksë e obligueshme prej 18% = 836.442 dhe total vetëm pagat e punëtorëve dhe tvsh = 5483.34

Llogarisim tutje $5483.34 \times 197,400.20$ euro pa llogaritur materialin e kërkuar nga ju si AK OE I shpallur fitues në këtë AP ka dhënë cmimin prej 197844.65 euro që diferenca mes cmimit të ofertuesit fitues dhe pragut të pagave është në diferencë prej gjithsej 444.41 euro me tvsh për 36 muaj apo për muaj = 12.34 euro me tvsh pa tvsh 10.46 euro , atëherë si keni menduar ju si AK që ky OE mund të mbuloj shpenzimet e materialit , apo a keni kërkuar ndonjë sqarim në lidhje me këtë që është sepse është e palejueshme që OE të manipulojë me pagat të punëtorëve për të shmangur ndonjë vlerë nga to e për të furnizuar me material shërbimet e pastrimit në të dy objektet e kontratës.

Andaj ju utem që këtë kërkesë për rishqyrtim ta keni parasysh dhe ta aprovoni si të bazuar dhe lëndën ta ktheni në rivlersim.

Dëmet materiale

Mundesia e shperblimit me kontrate

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE MEB LLC dhe OE Extreme Clean sh.p.k.:


Pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, duke marre parasysh se OE i rekomanduar i ka plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara ne NJK dhe DT.

Nuk qendron pretendimi i **MEB LLC** ne lidhje kalkulimin e pagave dhe me koston e materialit duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka çmimin e ofertes 197,844.65 € ndersa oferta juaj eshte 199,480.32 €, ose vetem 1,635.67 euro me shtrenjte. Dallimi ne mes dy ofertave eshte minor ose rreth 0.8% andaj ofertat e juaja jane gati te barabarta per ta kontestuar çmimin e OE te rekomanduar.

Nuk qendron pretendimi **Extreme Clean sh.p.k.** ne lidhje kalkulimin e pagave dhe me koston e materialit duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka çmimin e ofertes 197,844.65 € ndersa oferta juaj eshte 198,680.66 €, ose vetem 836.01 euro me shtrenjte. Dallimi ne mes dy ofertave eshte minor ose rreth 0.4% andaj ofertat e juaja jane gati te barabarta per ta kontestuar çmimin e OE te rekomanduar.

OE i rekomanduar ne oferten e tije i ka plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara ne NJK dhe DT, i ka te nenshkruar Deklaratat nen Betim per te dy anetarët e konsorciumit, i ka ofruar te gjitha dokumentet be kerkuara te Pershtatshmerise si dhe Sigurimin e ofertes – Policen Origjinale.

OE i rekomanduar ne oferten e tije e ka ofruar te gjitha deklaratat e kerkuara rreth vleres se pageses per punetoret 400€ neto si dhe afatit te pageses me se largu deri me date 05 te muajit ne vijim, shih me poshte deklaratat:



SH.P.K.
PRO TECH CLEAN
Adresa: Rr. Ndue Perlleshi, Nr.3.
Nr.unik: 811925413
E-maili: protechclean.shpk@gmail.com

DEKLARATË

Titulli: "Patrimi i Objekteve te ISSH dhe SHFAKM me nr të prokurimit 206-24-3189-2-1-1"

Ne si grup i OE: "Pro Tech Clean" SH.P.K. dhe "Aroma Plus" SH.P.K., deklarojmë me përgjegjësi të plotë materiale dhe ligjore se, punëtorëve do tua paguajë pagën minimale prej 400€ (neto) sipas Ligjit të Punës.

Datë: 27.05.2024,
Prishtinë

Deklaruesi: Pro Tech Clean SH.P.K.

Nenshkrimi:

Vula:





SH.P.K.
PRO TECH CLEAN
Adresa: Rr. Ndue Perllushi, Nr.3.
Nr.unik: 811925413
E-maili: protechclean.shpk@gmail.com

DEKLARATË

Titulli: "Patrimi i Objekteve te ISSH dhe SHFAKM me nr të prokurimit 206-24-3189-2-1-1"

Ne si grup i OE: "Pro Tech Clean" SH.P.K. dhe "Aroma Plus" SH.P.K., deklarojmë me përgjegjësi të plotë materiale dhe ligjore se, pagat e punëtorëve do t'i paguajmë për muajin paraprak, më së largu deri më datë 05 të muajit në vijim.

Datë: 27.05.2024
Prishtinë

Deklaruesi: Pro Tech Clean SH.P.K.

Nenshkrimi: 

Vula:




Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. MEB LLC
2. Extreme Clean sh.p.k.
3. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit